



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 27 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.09.2018, merr këtë

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E TEJKALIMIT TË TË HYRAVE VETANAKE DHE BARTJEN E BUXHETIT TË PASHPENZUAR NGA VITI 2017 NË VITIN 2018

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për tejkalimin e të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2017 dhe bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2017 në vitin 2018.

Neni 2

Qëllimi i vendimit të cekur në nenin 1, është rritja e tejkalimit të të hyrave vetanake dhe bartja e mjeteve nga programet e kontraktuara gjatë vitit 2017 që barten në vitin 2018, të destinohen sipas programeve të caktuara.

Neni 3

Rritja e të hyrave vetanake të cekura në nenin 2 të këtij vendimi, është në shumën prej 134.243,20 € dhe atë:

1. Në programin e investimeve kapitale dhe menaxhimin e kontratave, kategoria ekonomike (Investimet kapitale - Ndërtimi i rrugëve në pjesën urbane me infrastrukturë përcjellëse - kodi 18040/300), në shumën prej 134,243.20 €.
2. Gjithsej për bartje të mjeteve të kontraktuara, të cekura në nenin 2 të këtij vendimi, janë 13,928,725.90 €.

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe pjesa tabelore.

Neni 5

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjnë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-400/01-0237540/18, më 01.10.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

